

## FJALORËT E SADULLA ZENDELIT - DAJA

Si rrallëkush në histori, kombi ynë është shquar për një harmoni dhe për respekt mes njerëzve, por edhe për respekt kulture e tradite të tjetrit, për vlera humane. Shekujt përplasën mbi të rrebeshe luftërash të gjata, ngase fqinjët dhe pushtuesit tanë ndër mote na u vërsulën për të na zhdukur si komb, në vetëdijen tonë nacionale u ngjiz ideja e madhe për komb dhe atdhe. Atdhetarë në trevat shqiptare, të udhëhequr nga kjo ndjenjë magjike, udhëhoqën gjenerata të tëra drejt lirisë së atdheut. Le të kujtojmë kohën e sundimeve të ndryshme mbi truallin tonë, luftën e paepur të atdhetarëve e rilindësve tanë, dhe padyshim, në ditët e sotme bashkëkohore, në vargun e madh të këtyre burrave, bën dritë edhe emri, jeta dhe vepra e poetit, pedagogut, mësuesit, shkrimtarit, leksikografit dhe patriotit të madh Sadulla Zendeli - Daja.

*Gjuhën shqipe e kam sjellë nga vendlindja ime. Pa i harruar pllajajat e bekuara shqiptare, vendosa të largohem kudo qoftë: në qiell, në hënë, në parajsë, veç në skëterrë jo! Takimi i parë me Suedinë ishte sinjali, se ëndrra ime për arsim dhe liria e popullit tim do të realizohen. Ky ishte një orull atdhedashurie, nga dita e parë, në këtë vend nordik. (Daja)*

### **Gostivari i zemrave tona**

Natyra mahnitëse, toka, pozita e volitshme gjeografike, mbi 500m lartësi mbidetare, me gurgullimën e burimit të lumit Vardar, aty në perëndim të Maqedonisë; i rrethuar nga dy fortesa, Sharri dhe Mali i Thatë, dhe me shumë karakteristika të tjera, shtrihet i qetë, me banorët e atij qyteti të shumë ngjarjeve dhe personaliteteve të njohura, të kulturës dhe jetës shqiptare, Gostivari. Për ta soditur për së afërmi panoramën e mrekullueshme të këtij qyteti, qoftë duke ardhur nga Tirana, në

Ohër, për në Gostivar ose nga Prishtina, Shkupi e Tetova, për në Gostivar, shfrytëzohen autostrada moderne, që shkulin nëpër fushën e gjerë të Pollogut.

Në vitin 1850, gjeologu dhe balkanologu Ami Beu, në përshkrimet për Tetovën, ndër të tjera, në një pjesë thotë se në Pollog gjendej “fshati i madh”, Gostivari. Ndërsa si qytet, për herë të parë, ai është përmendur në dy shkrimet e shekullit XIX. Sipas tyre, ky vendbanim i Pollogut ka formuar çarshinë e vet (qendrën), kurse e marta ka qenë ditë pazari. Në vitin 1874, qyteti ka pasur 400 shtëpi, rreth 2.000 banorë, ndërsa në fund të shekullit të njëjtë, 3.500 banorë. Bazuar në shkrimet e Abdylhaqim Doganit, Gostivari e mori emrin nga vajza, që kishte ardhur nga Tivari, e cila zgjodhi për vendbanim këtë qytet. Në gjuhën lokale, vajza quhet gocë edhe atë nga Tivari. Prandaj doli emri Gostivar, nga goca e Tivarit.

Një krenari e madhe për Gostivarin është edhe hero i madh, Xhem Gostivari. Po ka edhe heronj të tjerë, siç është inxhinieri më i njohur në ish-Jugosllavi, një hero i madh i fshatit Koritë, Bilall Selimi, i cili është zhdukur nga njerëz të panjohur. Fshati Koritë mund të krenohet edhe me Malik Azizin, i cili kishte një vizion shumë përparimtar për popullin shqiptar. Ky hero është vranë nga njerëzit, që në atë kohë bashkëpunonin me shërbimin e fshehtë sllav. Në rrethinën e Gostivarit, në fshatin Simnicë, lindi Xhemë Hasë Gostivari. Ishte ikona e trimërisë shqiptare, që në këto pjesë të Shqipërisë lindore korri 13 beteja kundër sllavo-komunistëve. Prandaj duhet ndriçuar kjo figurë historike, që i riktheu popullit shqiptar dinjitetin dhe heroizmin e pashoq, pas luftërave të Skënderbeut, në këtë pjesë të Shqipërisë Lindore. (Burime, të huazuara nga Wikipedia)

Gostivari me rrethinë gjatë historisë ka qenë qendër e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Gjatë Lidhjes së Prizrenit, Gostivari mori pjesë drejtpërdrejt duke dërguar delegatët e vet kur vendosej për fatin e Shqipërisë. Po ashtu, Gostivari ka marrë pjesë edhe në Lidhjen e Pejës, ku u lidhë “Besa” udhëhequr nga Haxhi Zeka. Gjithashtu, Gostivari me rrethinë ka marrë pjesë edhe në kryengritjen e vitit 1912, kur valoi flamuri kombëtar në kalanë e Shkupit më 12 gusht 1912. Po ashtu, Gostivari ka

marrë pjesë dhe në Lidhjen e Dytë të Prizrenit, ku u vendos në marrjen e Shkupit, ku Xhemë Gostivari me bashkëluftëtarë e çoi lart flamurin kombëtar tek ura e Gurit më 12 shtator 1944. Pas rënies së vendeve tona nën sundimin e parë serb, Gostivari me rrethinë i tërë u çua në këmbë burra e gra dhe mori pjesë aktive në kryengritjen e shtatorit në vitin 1913. Kryengritja e shtatorit pati jehonë të madhe në popullin e rrethit të Gostivarit, pasi serbët morën vesh se shqiptarët ishin ngritur të gjithë për të shkuar në Shkup, për të luftuar pushtuesin serb në këto anë. Çetës kryengritëse shqiptare, që erdhi nga Dibra nëpër Kërçovë e që komandohej nga Emin Beu, kur iu afrua Gostivarit, i doli përpara tërë fshati Simnicë, burra e gra, të cilët u bashkuan me kryengritësit.

Pas shuarjes së kryengritjes, ushtria serbe vrau burra, gra e fëmijë të këtij fshati. Gjithsej u vranë 48 veta dhe nga 116 shtëpi që kishte fshati, 113 u dogjën. Humbje të mëdha pësoi familja e gjyshit të Xhemë Hasës, Esat Ali Hasa, si kryeplaku i fshatit, i cili u vra nga dora e vetë komandantit serb dhe trupi i tij u hodh në zjarr.

Ushtria serbe nuk u ngop me masakrat që bëri në fshatin Simnicë dhe, 8 ditë pas tërheqjes së saj, në fshat vijnë përsëri çetat çetniko-serbe, me në krye Dimitër Gjokën, dhe kërkojnë disa persona. Pasi i lidhën, i nisën për në prefekturë dhe gjatë rrugës, te vendi i quajtur "Vakuf i Bajnicës", i vranë që të gjithë.

Punën e filluar të këtyre burrave për liri e arsimin e vazhdoi me përkushtim Josip Bageri si një rilindës i shquar i këtyre trevave, i cili që herët ishte futur në luftë për liri dhe pavarësi, për arsimim dhe demokratizim të trevave shqiptare në këto anë. Bageri kishte kuptuar se shkolla është një prej burimeve të pashtershme dhe një burim kryesor për një komb që të jetoj në liri. Të gjitha fuqitë e veta i kishte drejtuar në hapjen e shkollave shqipe në gjuhën amtare në kohën e sundimit të xhonturqve dhe zhvillimin e arsimit.

Rrugën e këtij patrioti e ndoqën edhe shumë patriotë të tjerë nga troje jetike shqiptare, e një ndër ta është edhe Sadulla Zendeli-Daja, mësues, pedagog, poet dhe leksikograf i njohur.

### Vlera e jeta shqiptare, apo drita shqiptare në Skandinavi

Sadulla Zendeli-Daja lindi në fshatin Sërmnovë të Gostivarit, më 3 qershor 1935. Shkollimin fillestar e ka kryer në vendlindje dhe në Vrapçisht, kurse gjimnazin (dega e ekonomisë), e filloi në Gostivar dhe e kreu në Strumicë. Pas mbarimit së shkollës, u punësua drejtor i kooperativës "Bukovik", në fshatin Sërmnovë. Pastaj punoi në Sipërmarrjen e Hekurudhave të Shkupit (dega e Gostivarit). Si njeri dhe intelektual me ide përparimtare, Daja që herët nisi veprimtarinë e tij atdhetare, duke iu kundërvënë në mënyra të ndryshme pushtetit të atëhershëm komunist, i cili me çdo kusht tentonte t'i zhbënte shqiptarët nga faqja e dheut.

Vendlindja e tij ishte e pushtuar nga nacionalistët sllavë, të cilët emigruan nga Kaukazi, saktësisht nga Mali dhe lumi Dnjestër e Dnjepëri, për t'u instaluar në tokat arbërore. Në dilemën e bashkëpunimit me "pushtuesit sllavë" dhe largimit, kjo e fundit do të ishte zgjidhja e vetme. Daja kujton: "Zgjodha më të mirën e së keqes dhe emigrova! Pse? Sepse, ndryshe, duhej të bëhesha spiun i vëllezërve të mi, i atyre që mbanin kësulë të bardhë, i atyre që e donin flamurin shqiptar, i atyre që këndonin dhe kërcenin valle shqiptare, i mësuesve dhe mjekëve, i të burgosurve politikë, që për "faj" kishin dashurinë për Shqipërinë dhe trojet tona të shkëputura nga shteti amë. E këtë nuk ma lejonte ndërgjegjja ta bëja, prandaj zgjedha edhe të keqen më të vogël, duke emigruar nga vendi im i dashur, nga ai vend ku çuditërisht gurët, që m'i vrisnin këmbët e z bathura, më dukeshin të butë. Më dukeshin sikur ecja mbi barin e njomë të vendlindjes sime të dashur! Pa i harruar pllajat e bekuara shqiptare, vendosa të largohem kudo qoftë, në qiell, në hënë, në ferr!".

Pikërisht, veprimtaria e tij prej atdhetari u bë halë në sytë e regjimit të atëhershëm, e mu për këtë arsye, në vjeshtën e vitit 1966, Daja u shtrëngua ta braktisë vendlindjen dhe të kërkojë strehim në Suedi. Tani, ai kujton: "Fati më ndihmoi që të ma zbuste këtë dhimbje, duke më çuar në kontinentin nordik. Kam prekur tokën e ftohtë të tij, me besimin se ëndrra ime për arsim dhe liria e popullit tim do të realizoheshin. Me drojën e një emigranti "pa atdhe", do të nisja aventurën emigruese, por me fatin e madh se do të isha një qytetar i një shteti, që pas njëmijë

jetëve në vendin tim, Suedia do të ishte e para në radhë.

Takimi i parë me Suedinë ishte sinjali se ëndrra ime për arsim dhe liria e popullit tim do të realizohen. Kjo ishte një vrull atdhedashurie, nga dita e parë në këtë vend nordik. Që ditën, kur kam dalë nga Universiteti i Uppsalës dhe kam shijuar lirinë, rendin, urtësinë në këtë shtet skandinav, i thashë vetes: - Kjo ishte drita ime në mjegull, t'i ndihmoj popullit dhe ky vend më frymëzon! Kur hyn thellë në shpirtin suedez, të jepet forcë, fuqi, ide. Nëse hyn në shpirtin suedez, gjen gjëra shumë të mira, se kemi edhe ne, shqiptarët, gjëra shumë të mira dhe këtu bëhet pikëtakimi. Të mos ishte Suedia, unë s'do t'i arrija këto rezultate. Dëbimi i shqiptarëve nga Atdheu është i dhimbshëm, por kjo është një pasqyrë e jetës sonë, e punës sonë dhe e fatit tonë historik. Mërgimi në Suedi më bëri që të shkëputem nga mentaliteti ballkanik, të integrohem në shoqëri me një demokraci të lartë, me një përvojë të sprovuar. Po kështu, ky vend më dha mundësi të shmangem nga dioptria shkurtpamëse”.

\* \* \*

Sadulla Zendeli-Daja, do të ishte ndër të parët mësues të gjuhës amtare në Skandinavi. Ai nisi të përcjellë ndër bashkëkombësit, të rinjtë e fëmijët mesazhet e ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës amtare, të kulturës dhe traditës shqiptare në mërgatë, veçanërisht në Suedi, aty ku kultura qytetare, respekti dhe zhvillimi i demokracisë kishin arritur kulmin e zhvillimit. Por ndihej e domosdoshme që idetë demokratike të respektoheshin me tolerancë dhe sidomos me tradita dhe kulturë të pasur shqiptare.

Nga shekulli në shekull, kjo fushë ka ardhur duke u lëvruar më shumë, e rrjedhimisht edhe fjalorët e hartuar u rritën në numër. Një zhvillim të madh leksikografia shqiptare pati sidomos në shekullin XX dhe sidomos në gjysmën e dytë të tij, veçanërisht në vitet '90 të atij shekulli. Kjo lëmi është zhvilluar jo vetëm brenda territorit shtetëror shqiptar, por edhe në vende të tjera, kryesisht aty ku jetojnë shqiptarë. Është mjaft evident ky fakt që ka sjellë edhe më shumë interesin për hartimin e fjalorëve dygjuhësh.

Janë hartuar fjalorë, jo vetëm nga filologë shqiptarë, por edhe

nga albanologë të huaj, të cilët kanë pasur dhe kanë luajtur një rol mjaft me rëndësi. Këta fjalorë kanë ndikuar që shqipja të përballet me shumë gjuhë, ku si rrjedhojë e kësaj pune të palodhur të filologëve dhe leksikografëve tanë, shqipja është vënë në krah të të gjitha gjuhëve të Ballkanit, në kushtet e bashkësisë së territorit, të nevojave të komunikimit ndërgjuhësor e të shkëmbimeve ndërkulturore. Pjesë e kësaj pasurie janë padyshim edhe fjalorët suedisht-shqip, të autorit Sadulla Zendeli-Daja, që po paraqesim këtu sot. Këta glosarë janë të parët në llojin e vet, botuar në Suedi, fryt i një pune të kujdesshme, mbledhëse, përzgjedhëse e sistematizuese të poetit, përkthyesit, mësuesit, atdhetarit dhe leksikografit tonë të njohur, Sadulla Zendeli-Daja.

Fjalori i parë suedisht-shqip, me 17.000 fjalë të përdorimit të zakonshëm, të zgjedhura e të përpunuara nga një fond prej 27.000 fjalësh, u botua për herë të parë më 1994, nga Agjencia Kombëtare Suedeze për Arsim (Enti për zhvillim i Suedisë). Autor i përkthimit dhe inkodimit është Mr. fil. Sadulla Zendeli-Daja, në Suedi, me redaktor Ullmar Qvick-un në Suedi, dhe Svijetllana Mihali, në Shqipëri. Fjalori i ka ndihmuar shqiptarët ta ruajnë me dashuri gjuhën amtare shqipe dhe të pengojë tjetërsimin e tyre gjuhësor. Fjalori ka pasur për mision të bëhet edhe mjet plotësues arsimimi për një shtresë të gjerë përdoruesish. Fjalori i dytë suedisht-shqip, me 28.500 fjalë të përdorimit të zakonshëm, të zgjedhura e të përpunuara nga një bazë prej 54.000 fjalësh, u botua më 2004, nga "Agjencia Kombëtare Suedeze për Arsim" (Enti për Zhvillim i Suedisë). Autor i përkthimit dhe inkodimit është Mr. fil. Sadulla Zendeli-Daja, me redaktor Svijetllana Mihali, Shqipëri, dhe prof. dr. Shefkije Islamaj, këshilltare shkencore dhe përgjegjëse e sektorit të leksikografisë, në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Fjalori respektiv përmban numër të madh kuptimesh e ngjyrimesh kuptimore, sinonime, thënie e idioma. Ai përmban edhe 66 faqe fotografi tematike me ngjyra. Fjalori i tretë për fëmijë me titull "Fjalori im i parë i ilustruar 4 gjuhësh: shqip-anglisht-italisht", nga autorja Meri Toçi. Versionin shqip-suedisht e ka përkthyer Mr. fil. Sadulla Zendeli-Daja. Fjalori ka 176 faqe, rreth 1000 zëra, rreth 1000 ilustrime me ngjyra, i pajisur me fjalor anglisht-shqip-italisht-suedisht, italisht-anglisht-suedisht-shqip,

suedisht-anglisht-italisht-shqip. Një fjalor i dobishëm, zbavitës dhe me një përdorim shumë të thjeshtë për prindër dhe mësues, të cilët dëshirojnë t'i drejtojnë fëmijët në mësimin e një gjuhe të huaj. Janë zgjedhur fjalë të përdorimit të zakonshëm, të lidhura me jetën e përditshme, familjen, shtëpinë, lojërat dhe shkollën. Ilustrimet e këndshme me ngjyra, të cilat shoqërojnë çdo fjalë, e bëjnë konsultimin me tekstin më të thjeshtë dhe zbavitës. Një fjalor, i cili ka qëllimin e dyfishtë: t'u japë prindërve dhe mësuesve udhëzime të qarta si mbështetje të punës së tyre dhe fëmijëve një instrument të këndshëm loje dhe kuptimi.

Fjalorin e katërt shqip-suedisht, me rreth 35.000 fjalë, e boton Shtëpia Botuese "Toena" në Tiranë, më 2013. Fjalori pasuron dhe barazon leksikografinë e të dy gjuhëve, suedisht dhe shqip, dhe plotëson zbrazëti të ndjeshme për fjalorë të këtij lloji, në të dy leksikografite. Ka karakter shkencor e normativ, dy kritere me vlerë për leksikografinë e mirëfilltë bashkëkohore, teorike e praktike. Ky projekt përmbush të gjitha kriteret mbi të cilat ndërtohen fjalorët dygjuhësorë bashkëkohorë. Është punuar me kujdes të veçantë sa i përket makrostrukturës së tij dhe përmban informacione shitesë për jetën, kulturën e psikologjinë e popullit shqiptar dhe atij suedez, me çka paraqet pasurim lëndor e me vlerë për përdoruesit. Fjalori ka anën e tij praktike të përdorimit, dhe këtë anë e siguron përzgjedhja e duhur teknike e trajtimit të lëndës gjuhësore. Në fjalor janë trajtuar me kujdes njësitë leksiko-semantike, fusha e informacionit të çdo zëri leksikografik, përkufizimet e shpjegimet, sinonimet e antonimet. Një punë jo e vogël është bërë në plotësimin e strukturës semantike brenda fjalës.

Zoti Zendeli, gjatë punës me këta fjalorë, ka bërë kujdes t'i shmanget përkthimit të fjalëpërfjalshëm, i cili është një grackë, që vështirë mund të kapërcehet edhe nga autorët më të sprovuar. Përkrah fjalës suedishte, qëndron fjala shqipe, me shpjegimet dhe shembujt përkatës të barasvlerëshëm dhe me ngarkesat kuptimore e gjithë të tjerat. Barasvlerësit (ekuivalentët) shqip të fjalëve suedishte, pra fjalët shqipe, janë shoqëruar edhe me sinonime të shumta, pa lënë mënjanë as antonimet, të cilat së bashku e saktësojnë dhe e qartësojnë më mirë kuptimin e fjalëve. Përdorimi i dendur dhe me vend i sinonimeve është një vlerë e veçantë e këtij fjalori. Autori i ka kushtuar një vëmendje të madhe

edhe pastërtisë së gjuhës shqipe, duke iu shmangur përdorimit të fjalëve me prejardhje të huaj. Kjo kurdoherë ka qenë e mundur, duke përdorur edhe fjalë të brumit të gjuhës shqipe. Kjo shihet më së miri te vargjet sinonimike, ku gjithherë në krye të renditjes sinonimike janë vënë fjalësinonimet shqipe, që ndiqen pastaj edhe nga fjalë me prejardhje të huaj. Thënë shkurt, para nesh kemi një fjalor shumë të mirë.

Pra, te fjalorët e Dajës gjejmë një numër të madh kuptimesh e ngjyrimesh kuptimore, sinonime e antonime, thënie e idioma, nga më të ndryshmet. Ai ka 930 faqe të formatit të madh dhe 66 faqe me fotografi ilustruese, me ngjyra dhe me tematikë nga shumë fusha të jetës së njeriut, duke filluar nga familja e farefisi e deri tek artet pamore e dëgjimore, sporti e argëtimi. Teknikisht, fjalorët e Dajës janë përgatitur në shkallë të lartë dhe i bashkohen serisë së fjalorëve të tjerë, që e ndërlikojnë suedishten me gjuhë të huaja. Po ashtu, trajtimi leksikografik i lëndës gjuhësore ndjek rrugën e fjalorëve standardë të leksikografisë shqiptare.

Një anë shumë e vlefshme e këtyre fjalorëve, që duhet vënë re në veçanti, është karakteri i tyre normativ, që përfshin të gjitha rrafshet e gjuhës, që nga fonetika, morfologjia, sintaksa, leksiku, fjalëformimi, deri edhe rrafshin e stilistikës. Me këtë rast, mund të themi lirisht se këta fjalorë, padyshim, janë me një rëndësi të lartë, sepse pasurojnë leksikografinë e dy gjuhëve, përmbushin të gjitha kriteret mbi të cilat ndërtohen fjalorët dygjuhësorë bashkëkohorë, përmbajnë kuptime shtesë për kulturën e psikologjinë e popullit suedez, edhe pse kanë anën e tyre praktike të përdorimit. Prandaj, këto botime leksikografike u mirëpritën me interes të madh nga lexuesit e përdoruesit shqiptarë, por edhe nga ata suedezë.

Mund të thuhet se Fjalori suedisht-shqip i Entit për Shkollim të Suedisë është një fjalor me rëndësi të madhe, sepse pasuron leksikografinë e të dy gjuhëve, suedishte e shqipe, plotëson zbrazëti të ndjeshme për fjalorë të këtij lloji, përmbush të gjitha kriteret mbi të cilat ndërtohen fjalorët dygjuhësorë bashkëkohorë, përmban informacione shtesë për jetën, kulturën e psikologjinë e popullit suedez dhe sepse ka anën e tij praktike të përdorimit dhe këtë anë e siguron përzgjedhja e duhur teknike e trajtimit të lëndës gjuhësore.

Fjalorët përmbajnë fjalë dhe shprehje të përdorimit të përditshëm dhe të veçantë të gjuhës suedeze përgjegjëse në gjuhën shqipe. Kur kemi të bëjmë me pjesën e shqipes, këtu është përfshirë leksiku aktiv, por jo rrallë edhe leksiku pasiv dhe ai potencial i shqipes për t'i dalë ballë fjalësit të suedishtes. Në fjalorë janë përfshirë edhe një numër fjalësh të reja, fjalësh pak të njohura, fjalësh të huaja që kanë karakter ndërkombëtar, dialektizma që janë marrë nga të dy krahët, pra nga dy dialektet e shqipes, nga gegërishtja e toskërishtja, në mbështetje të vlerës së tyre objektive brendapërbrenda strukturës leksikore të tyre për të ndihmuar shpjegime saktësore dhe përkufizime të termave profesionale. Hasim në diku mbi 1000 emërtime nga sfera shoqërore, të cilat janë të shoqëruara me shpjegime dhe sqarime të nevojshme për përdoruesit e tyre. Fjalorët në pjesën e tyre të fundme kanë një numër të madh fotografish tematike të shoqëruara me tekst, që janë përzgjedhur nga autori me mjeshtri dhe kujdes në mënyrë që përdoruesi të jetë më i sigurt në përdorimin e termave dhe fjalëve të nevojshme, duke filluar nga familja, veshmbathja, banimi, kuzhina, tekstili, shëndetësia, higjiena, puna, arsimit, shkolla, mjedisi, bimësia, shtazëria, informimi publik, artet pamore, sporti, kultura, bujqësia, ekonomia, duke përfshirë, pra, një spektër të gjerë njësisht leksikore nga sfera të ndryshme të punës dhe jetës.

Pra, trajtimi i njësive leksiko-semantike, të çdo zëri leksikografik, përkufizon shpjegimet e sinonimeve dhe antonimeve me shembuj ilustrues dhe frazeologji si dhe me karakteristika gramatikore të shkurtesave me kujdes dhe në mënyrë profesionale nga ana e autorit. Sinonimet janë shfrytëzuar duke pasur për mbështetje përdallimin dhe marrëdhëniet semantike midis tyre. Këtu hetohet përpjekja e autorit që në çdo rast të jepet kuptimi i përgjithshëm e më i saktë i ngjytimeve kuptimore, të kuptimit figurativ dhe përdorimit e tjera funksionale të fjalës. Autori në shumicën e njësive leksikore jep shembuj të shumtë ilustrues kur kemi të bëjmë me përdorimin e frazeologjisë. Por është shumë me vlerë se këta fjalorë ndjekin rrugë të fjalorëve dygjuhësorë.

Fjalorët janë vepra të vështira për t'u hartuar e krijuar. Ndaj ata janë të rrallë dhe nuk mund të krijohen çdo gjashtë muaj ose çdo një vit. Pikërisht për këtë, ne e vlerësojmë fjalorin e Dajës, një vepër të madhe shkencore të diasporës shqiptare, që zë tashmë vendin e saj të nderuar në bibliotekën e fondit albanologjik.

Me veprën dhe veprimtarinë e tij, Sadulla Zendeli i bën nder bashkësisë shqiptare në Suedi. Ai jep shembullin e madh të vitalitetit, që ekziston në gjirin e kombit shqiptar, bijtë e të cilit, ndonëse në kushte jo të lehta, por plot brenga e mall të mërgimit, kanë ditur të renditen me dinjitet dhe të barabiten me shoqëritë demokratike e të zhvilluara, ku fati i solli që të jetojnë. Daja jep shembullin e madh të njeriut, që nuk e nisi dhe ngrysi jetën vetëm duke psherëtirë "sa i zi është kurbeti"! Por ai i vuri vetës qëllimin e lartë për të ngritur nderin e vetes dhe të komunitetit e të kombit që i takon, me vepra shkencore dinjitoze.

Vepra shkencore e Dajës dhe e gjithë veprimtaria e tij krijuese, artistike, poetike, prozaitike, figurative, muzikore, shkencore, sportive etj., si dhe e krijuesve të tjerë nga komuniteti shqiptar në Suedi, na mbushin me krenari ne të gjithëve, në këtë vend dhe në vende të tjera nordike. Mbushin me krenari diasporën shqiptare nëpër botë, trevat dhe fshatrat, ku u ka bërë koka "bam". Por, natyrisht, e mbushin me krenari kombin tonë liridashës dhe kulturëdashës. Fjalori suedisht-shqip është një urë lidhëse mes kulturës suedeze dhe asaj shqiptare, një urë lidhëse dhe bashkëpunimi ndërmjet dy popujve tanë, që e çmojnë dhe e respektojnë njëri-tjetrin.

Mua më dha një kënaqësi të veçantë fakti që ju e keni përjetuar botimin e veprës së Dajës, si një vepër të mbarë bashkësisë shqiptare këtu. Letrat dhe posta elektronike e shumtë, që ju i keni dërguar Dajës me rastin e botimit të fjalorit, shprehin një respekt dhe dashuri vëllazërore e përkujdesje, që vërtet të prekin.

\*\*\*

Të jesh përkthyes me gojë për mërgimtarët shqiptarë, duhet të kesh shpirt të madh, të jesh largpamës. Secili që mërgon, i ka hallet e veta shumë të mëdha, braktis vendlindjen, miq e shokë, shkulet nga një vend, ku i kanë jetuar të parët e tij. Përkthyesi duhet të bashkohet me shpirtin e këtij mërgimtari. Këshilla nuk

mund t'i japësh pse ka emigruar, përse ka lënë vendin. Por, në anën tjetër, përse ka emigruar edhe përkthyesi. Duhet t'i dalësh zot, si vëlla shqiptar, si njeriu yt. Si rrallë tjetër, në historinë e rruzullit tokësor, kombi ynë është shquar për harmoni dhe mirëkuptim mes njerëzve, por edhe për vlera humane dhe respekt ndaj gjuhës, kulturës dhe traditave të të tjerëve.

Sipas **Baki Ymerit**, Daja është Legjenda Shqiptare e Skandinavisë, ndërsa vlera reale e njeriut përcaktohet nga lartësia e realizimeve të tij. Atdhetarët tanë, në trevat shqiptare, të udhëhequr nga kjo ndjenjë magjike, u prinë gjeneratave të tëra drejt lirisë së mëmëdheut. E kujtojmë kohën e pushtimeve e sundimeve të ndryshme mbi truallin tonë, e kujtojmë luftën e paepur të patriotëve, të rilindësve tanë dhe, padyshim, në ditët e sotme, në vargun e madh të këtyre burrave, bën dritë edhe emri, jeta dhe vepra e poetit, pedagogut, mësuesit, shkrimtarit, leksikografit dhe atdhetarit të madh, Sadulla Zendeli-Daja.

**Haxhi Birinxhiku**, profesor në Norrköping (Me rastin e përrurimin të fjalorit suedisht-shqip) thotë: Daljet në dritë të veprave të shquara gjithmonë kanë qenë ngjarje të shënuara, për më tepër botimi i një fjalori dygjuhësh është një ngjarje e veçantë e kulturës, pra me peshë të dyfishtë. Ambasada Shqiptare po bën një punë fort të vyer, duke shënuar kështu botimin e Fjalorit suedisht-shqip të zotnisë Daja. Ky fjalor tani vjen te përdoruesit e tij më i njësuar, më i baraspeshuar dhe më cilësor. Do të thotë se autori asnjëherë nuk e ka ndërprerë veprimtarinë e tij kërkimore, në laboratorin e tij krijues prej leksikografi, për ta kurorëzuar atë me sukses.

Pikërisht, veprimtaria e tij prej atdhetari u bë halë në sytë e regjimit të atëhershëm, e mu për këtë arsye, në vjeshtën e vitit 1966, Daja u shtrëngua ta braktisë vendlindjen dhe të kërkojë strehim në Suedi. Tani, ai kujton: Erdha në mërgim, po si të flija i qetë! Çfarë të bëja për kombin tim? Përveç profesionit bibliotekar, u bëra mësues dhe mësuesi ka detyrë fisnike. Prandaj, pa u vonuar, bëra çmos që të hapja "tunele drite" dhe të bëja të pamundshmen, që fëmijët tanë të mos e harrojnë gjuhën e Atdheut. Si mësues, nga 2 orë, i shtova në 4 orë në javë. Paga mujore, si shef i bibliotekave, ishte më e lartë sesa paga e arsimtarëve, në një diferencë goxha të madhe. *Unë zgjodha udhën*